



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 45 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 5225 prot., datë 28.10.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit qeverisës të sistemit gjyqësor, i ngarkuar nga Kushtetuta për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, është i angazhuar maksimalisht në implementimin e Strategjisë Kombëtare për uljen e çështjeve të prapambetura në gjykata dhe, po aq i angazhuar, edhe për parandalimin e tyre në të ardhmen, me objektivin përfundimtar të funksionimit efikas dhe cilësor të sistemit të drejtësisë. Në këtë kuptim, ju përcjellim informacionin mbi ndjekjen dhe zbatimin e objektivave të Strategjisë referuar masave të marra nga Këshilli dhe gjykatat, si më poshtë vijon:

Lidhur me ndjekjen dhe zbatimin e objektivit strategjik nr.1: Ulja strukturore e numrit të çështjeve të prapambetura nëpërmjet marrjes së masave konkrete për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar Udhëzimin “Mbi miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata”, i cili përcakton rregullat bazë për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që do të regjistrohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit. Gjithashtu, Këshilli ka përditësuar vendimin nr. 78, datë 30.05.2019, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, duke shtuar llojin e çështjeve të cilat mund të shqyrtohen me përparësi në këtë gjykatë.

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit në funksion të zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji, masave dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin nr.253, datë 09.05.2024, “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata” dhe të procedurave të parashikuara në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, i

ndryshuar, prej muajit qershor 2024 ka nisur procesin e inventarizimit dhe klasifikimit të çështjeve në kategori prioritare.

Me urdhrat respektivë të Zëvendëskryetarëve të Gjykatave janë krijuar grupet e punës për inventarizim të dosjeve gjyqësore, konkretisht pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm një grup pune prej 8 (tetë) nëpunësish civilë gjyqësorë, si dhe pranë Gjykatës Administrative të Apelit një grup pune prej 6 (gjashtë) nëpunësish civilë gjyqësorë.

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm deri më tani janë inventarizuar afro 12500 çështje civile dhe penale, duke nisur nga çështjet me regjistrim më të hershëm në gjykatë (viti 2017) e deri në vitin 2024. Ndërsa, Gjykata Administrative e Apelit deri në datën 31.10.2024 ka përpunuar 13 983 dosje gjyqësore që i përkasin çështjeve të regjistruara në vitet 2018-2021, dhe po vijohet me inventarizimin e çështjeve të regjistruara në vitet 2022-2023.

Sjellim në vëmendje se çështjet e inventarizuara janë klasifikuar në bazë të llojit, natyrës, urgjencës dhe kompleksitetit. Ky proces është ende në vijim dhe parashikohet të përfundojë në fund të vitit 2024.

Ndërsa, nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezultojnë aktualisht 19595 çështje të mbartura nga viti 2023 për vitin 2024. Ndërkohë, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve administrative rezultojnë se nga viti 2023 janë mbartuar 7014 çështje për vitin 2024.

Sa i përket krijimit të ekipeve për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit, në bashkëpunim me projektin “Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritja e efikasitetit të gjykatave” i zbatuar nga East West Management Institute, kanë ngritur prej shtatorit 2024 ekipet për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura (NUNÇP) të cilët mbështesin trupën gjyqësore me përpunimin paraprak të çështjeve gjyqësore në kuadër të përgatitjeve për shqyrtimin e tyre. Konkretisht, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka ngritur një ekip prej 6 (gjashtë) nëpunësish, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit një ekip prej 5 (pesë) nëpunësish.

Në lidhje me masat e menaxhimit aktiv të çështjeve si dhe miratimit të një plani individual veprimi Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë janë në konsultim me gjyqtarët në mënyrë që të ulet sa më shumë numri i çështjeve të prapambetura.

Ndërkohë, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit në zbatim të procedurave të parashikuara në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, i ndryshuar, kanë mbajtur mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve ku kanë dakordësuar për të proceduar

edhe me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore të identifikuara me natyrë prioritare, krahas shqyrtimit të çështjeve të tjera që do të caktohen për gjykim sipas radhës së regjistrimit të tyre në këto gjykata. Gjithashtu, në vijim të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm do të miratojë grup-çështjet prioritare. Paraprakisht ju janë shpërndarë gjyqtarëve listat e çështjeve të natyrës prioritare me qëllim që të shqyrtohen nga gjykata në të njëjtën kohë dhe në mënyrë unanime nga trupa gjyqësore, gjë që do të shkurtojë kohën e nevojshme për shqyrtimin e tyre dhe do të mundësojë marrjen e vendimeve (standarde).

Këshilli i Gjykatës Administrative të Apelit ka miratuar vendimin nr.41, datë 03.10.2024 “Për krijimin e listave të grup çështjeve me qëllim përmirësimin e shpejtësisë, të efektivitetit të gjykimeve dhe uljen e çështjeve të prapambetura, si dhe përcjelljen e tyre gjyqtarëve relatorë për vlerësim e shqyrtim me përparësi”. Këshilli i Gjykatës, duke pasur parasysh se deri në datën 31.10.2024 janë inventarizuar 13 983 dosje gjyqësore që i përkasin çështjeve të regjistruara në vitet 2018-2021, nga të cilat 5469 çështje bëjnë pjesë e kategorive prioritare për shqyrtim, ka identifikuar 985 çështje gjyqësore duke krijuar listat përkatëse të grup-çështjeve, për përgatitje dhe shqyrtim më me përparësi, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë, të efektivitetit të gjykimeve dhe uljen e çështjeve të prapambetura në Gjykatën Administrative të Apelit. Këto lista grup çështjesh janë shpërndarë menjëherë për vlerësim dhe përgatitje gjyqtarëve relatorë për ti përgatitur për shqyrtim me trupat gjyqësore përkatëse. Trupat gjykuese kanë filluar procedurat për caktimin e datave për shqyrtim dhe gjykimin e çështjeve gjyqësore sipas listave përkatëse të grup çështjeve të identifikuara nga Këshilli i Gjykatës, krahas përgatitjes dhe shqyrtimit të çështjeve të tjera nisur nga radha e regjistrimit të tyre në Gjykatën Administrative të Apelit. Deri më tani, janë përpunuar dhe përgatitur për shqyrtim 186 çështje gjyqësore dhe janë programuar për shqyrtim gjatë muajit Nëntor 2024, 98 çështje gjyqësore nga listat e grup çështjeve më prioritare. Më tej, gjatë muajve Nëntor-Dhjetor e në vijim secili relator dhe trupë gjykuese do të programojë shqyrtimin e çështjeve përkatëse nga këto lista prioritare.

Lidhur me hartimin e një plani individual të veprimit Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit ende nuk kanë miratuar një të tillë. Bëjmë me dije se për shkak të volumit të madh të çështjeve të prapambetura dhe zhvillimit me rigorozitet të procesit të inventarizimit duke i kushtuar vëmendje një sërë të dhënash të cilat duhen vlerësuar me qëllim inventarizimin e saktë të çështjeve, për hartimin e një plani veprimi është e nevojshme pasja e një pasqyre konkrete me të dhëna të sakta në të cilën të bazohen edhe indikatorë matës. Gjithashtu, periudha shtator-dhjetor 2024, gjatë së cilës edhe po zbatohen objektivat 1.1-1.3 do t'i mundësojë gjykatës të dhëna bazë për të miratuar më pas për vitin e ri 2025 edhe planin përkatës të veprimit, mbështetur në të dhëna konkrete rreth natyrës dhe llojit të çështjeve të prapambetura, numrin e plotë të çështjeve me natyrë prioritare, ecurinë e vendimmarrjes duke u mbështetur në informacionin paraprak të hartuar nga ekipi i uljes së numrit të çështjeve të prapambetura, me qëllim evidentimin e masave dhe afateve konkrete për zbatimin e tyre, duke përcaktuar indikatorë matës konkretë për rritjen e produktivitetit dhe uljen e çështjeve të prapambetura.

Lidhur me ndjekjen dhe zbatimin e objektivit strategjik nr.2: Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit (gjyqtarëve dhe ndihmësve ligjorë)

Këshilli i Lartë Gjyqësor në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe në përmbushje të këtij objektivit strategjik vijon angazhimin maksimal në plotësimin e vakancave në sistemin gjyqësor. Në tetor 2024 Këshilli ka caktuar në pozicion 32 (tridhjetë e dy) gjyqtarë të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2023-2024. Ndërsa, referuar projeksioneve të hartuara në përputhje me kuotat e miratuara nga Këshilli, pritet që për tre vitet e ardhshme të përfshihen në sistemin gjyqësor edhe 105 gjyqtarë të rinj.

Megjithatë, referuar nenit 35, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, procesi i emërimit të kandidatëve magistratë ndërvaret nga një sërë faktorësh, si diplomimi në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme; vlerësimi minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar; si dhe ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat. Gjithashtu, theksojmë se plotësimi i vakancave në sistemin gjyqësor është një proces kompleks dhe ndërvaret edhe nga faktorë të tjerë si procesi i rivlerësimit kalimtar, numri i gjyqtarëve që pritet të mbushin moshën e pensionit të pleqërisë, numri i gjyqtarëve që i nënshtrohen një procesi disiplinor apo dorëheqje të mundshme.

Po ashtu, Këshilli ka zbatuar mekanizmin e Skemës së Delegimit duke caktuar 2¹ (dy) gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Apelit, në funksion të plotësimit të vendeve vakante pranë kësaj gjykate.

Mekanizma të tjerë në kuadër të plotësimit të vakancave janë edhe ngritjet në detyrë dhe lëvizjes paralele në gjykata. Konkretisht, që prej miratimit të Strategjisë Këshilli ka ngritur në detyrë 3² (tre) gjyqtarë dhe 2³ (dy) të tjerë janë caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu, në funksion të plotësimit të vendeve vakante, Këshilli ka transferuar përmes mekanizmit të lëvizjeve paralele 1 (një) gjyqtar.

Në kuadër të Strategjisë dhe me qëllim ekuilibrimin e ngarkesës së gjykatave në Shqipëri dhe sigurimin e një rishpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve në juridiksion apeli, Këshilli ka propozuar rritjen e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit, nga 13 në 22 gjyqtarë, si dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë nga 408 në 417 gjyqtarë⁴.

Sa i përket rritjes së numrit të ndihmësve ligjorë në kuadër të plotësimit të vakancave aktuale, vlerësojmë të përmendim faktin se në përfundim të formimit fillestar pranë

¹ Me vendimet nr. 592 dhe 593, datë 09.10.2024.

² Me vendimet nr. 483, datë 31.07.2024; nr. 588, datë 09.10.2024; nr.591, datë 09.10.2024.

³ Me vendimet nr. 282 dhe nr. 283, datë 29.05.2024.

⁴ Me vendimin nr. 585, datë 09.10.2024.

Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2023-2024, rezulton se 6 (gjashtë) ndihmës ligjorë janë pranuar në shërbimin civil gjyqësor në muajin tetor të vitit 2024. Ndërsa, për vitin 2025 Këshilli ka nisur procedurën e verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës viti akademik 2024-2025, për 11 (njëmbëdhjetë) ndihmës ligjorë⁵.

Gjithashtu, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe profesionalizimit të administratës gjyqësore në gjykatat e të gjitha niveleve, rezulton se për vitin 2024 janë trajnuar 113 (njëqind e trembëdhjetë) nëpunës civilë gjyqësorë.

Lidhur me ndjekjen dhe zbatimin e objektivit strategjik nr.3: Përmirësimi i metodave të punës

Sa i përket delegimit të detyrave të caktuara në lidhje me çështje të thjeshta nga gjyqtari te stafi i gjykatës (ndihmës ligjorë dhe/ose sekretarë gjyqësorë me përvojë) nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është hartuar një format standard që mundëson hedhjen nga nëpunësit e ekipit për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura të historikut të çështjes, me qëllim ardhjen në ndihmë të ndihmësve ligjorë dhe gjyqtarëve në studimin më të shpejtë të çështjes. Ndërsa, në rregulloren aktuale të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe në draft rregulloren e re, disa nga detyrat e thjeshta kryhen nga sekretaret gjyqësore të gjyqtarëve.

Gjykata Administrative e Apelit ka hartuar një format standard relacioni që mundëson hedhjen nga ekipi për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe nga ndihmësit ligjorë të të dhënave të nevojshme për relativim dhe shqyrtim të çështjes nga trupa gjyqësore, si edhe për të ndihmuar efektivisht edhe procesin e arsyetimit të vendimeve në lidhje me këto çështje.

Po ashtu, edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka ngritur një grup pune me sekretare gjyqësore për draftimin e akteve të ekzekutimit.

Ndërsa për sa i përket nxitjes së shkëmbimeve të versioneve elektronike të dokumenteve gjyqësore, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit përmes stafit mbështetës dhe falë ndryshimeve të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, mund të aksesojë drejtpërdrejtë versionin digjital të vendimmarjes së gjykatave të shkallës së parë, masë e cila kursen kohë të vlefshme në përgatitjen e çështjeve sidomos në gjykatën e apelit.

Ndërkohë, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë aktualisht kryhen vetëm njoftime elektronike (si fletëhirrjet apo dhe vendimet sipas legjislacionit të fuqi). Gjithashtu, me përfundimin e faqes së re elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të gjithë përdoruesit e saj do të kenë akses në marrjen e informacionit për çështjet gjyqësore.

⁵ Me vendimin nr. 618, datë 16.10.2024

Adresa; "Poli i Drejtësisë", Rruga "Ana Komnena", Tiranë, web;www.klgj.al, email;kontakt@klgj.al

Një masë tjetër efektive që do të ndihmojë në parandalimin e rritjes së numrit të çështjeve të prapambetura, përfshin promovimin e zhvillimit të seancave gjyqësore në distancë. Një metodë e përdorur nga gjykatat shqiptare gjatë periudhës së pandemisë, në kushte të jashtëzakonshme, por që aktualisht vijon të përdoret në praktikën e gjykatave të huaja edhe si një metodë pune në kushte normale. Meqenëse kohëzgjatja e seancave gjyqësore është një nga faktorët kryesorë që ndikon në ngarkesën e gjyqtarëve, një rritje/ulje e mundshme e çështjeve të prapambetura, mund të ndikohet nga zbatimi i një mase të tillë. Kjo masë mund të jetë veçanërisht e aplikueshme për çështjet e standardizuara dhe të thjeshta.

Në lidhje me zhvillimin e seancave gjyqësore në distancë, bëjmë me dije se pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë aktualisht zhvillohen në distancë vetëm çështjet gjyqësore të seksionit familjar. Ndërsa, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë zhvillohen seanca në distancë në bazë të kërkesës së palëve ose përfaqësuesve të tyre. Sa i përket Gjykatës Administrative të Apelit aktualisht nuk ka pasur raste, nuk ka kërkesa dhe as nuk janë krijuar rrethana dhe motive, për të cilat në këtë gjykatë të jenë e nevojshme dhe të zhvillohen seanca gjyqësore në distancë.

Lidhur me përdorimin e modeleve standarde për vendimet gjyqësore/ urdhrat e gjykatës e dokumente të tjera, bëjmë me dije se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit kanë hartuar e miratuar modele standarde për hartimin e relacioneve nga ana e ndihmësve ligjorë apo formularin e përpunimit paraprak të çështjeve nga ana e ekipit për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Ndërsa nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk rezulton të ketë ende modele standarde me të cilat të punohet të cilat reduktojnë kohën e nevojshme për përpilimin e vendimeve apo akteve të tjera në gjykata.

Sa i përket zgjedhjes më efektive të trupave gjykues të gjykatave të apelit, nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit që prej vitit 2023 është bërë një inventarizim i posaçëm i të gjitha dosjeve gjyqësore për të evidentuar gjyqtarët që kanë marrë pjesë më parë në shqyrtimin e çështjeve në këtë gjykatë apo në gjykata të shkallëve të tjera, në mënyrë që të shmanget krijimi në numër të konsiderueshëm dhe të pandërprerë të trupave gjyqësore të përziera. Për të reduktuar vonesat e shkaktuara nga krijimi i trupave gjykues të përzier, është i nevojshëm përmirësimi i mëtejshëm i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve që të mundësojë identifikimin e gjyqtarit e shkallës së parë.

Lidhur me ndjekjen dhe zbatimin e objektivit strategjik nr.4: Ndryshimet ligjore të përqëndruara në uljen dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura

Sikurse jeni në dijeni, në kuadër të lehtësimit të procesit të punësimit të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave, promovimit të një gjyqtari të vetëm, kufizimit të mundësisë së ankimit për një lloj çështje të caktuar, ndryshimeve ligjore në sistemin e lëshimit të

urdhrave të ekzekutimit, Këshilli ka përcjellë pranë Kuvendit dhe Ministrisë së Drejtësisë propozimet konkrete për ndryshime ligjore në Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!